

Nën organizimin e Fondacionit SOROS në Prishtinë, u mbajt tryeza e cila trajtoi problemet e energjetikës në Kosovë me temë “Ndërtimi i TC Kosova C me kapacitet 2100 MË dhe standardet e BE-së në fushën e energjisë”.

Në cilësinë e anëtares së kryesisë dhe si eksperte e fushës së energjetikës nga partia politike Aleanca Kosova e Re morri pjesë Znj. Myzejene Selmani. Znj. Selmani në këtë tryezë deklaroi se nuk është momenti i duhur të flitet për ndërtimin e TC Kosova C kur ne kemi probleme me dy Termocentralet tjera, Termocentralin Kosova A dhe termocentralin Kosova B dhe në momentin kur kemi probleme me rrjetin e dobët të shpërndarjes së rrymës elektrike. Kësaj duhet shtuar edhe kur kemi jo funksionim të ligjit për të gjithë sektorët dhe se qeveria nuk do të duhej të merrej me këtë problematikë shumë të rëndësishme përderisa statusi i Kosovës të mos zgjidhet. Standardet e BE-së janë të njohura për AKR-në dhe se në mënyrë që të plotësohen këto standarde duhet të kemi një strategji ku nuk do të kishim vetëm prodhim nga termo-energji por gjithashtu duhet të kemi alternative tjera për prodhim të rrymës nga uji, era, energji solare, energji gjeotermale ku duhet me çdo kusht duhet t’i plotësojmë këto standarde.

Pjesëmarrës në këtë konferencë nga partia ORA ishte z. Naim Hoxha dhe përfaqësuesi i PDK-së, z. Bajrush Xhemali. Tryezën e udhëhoqi z. Daut Maloku, kryetar i Partisë së Gjelbërve të Kosovës.